



BASHKIA MIRDITE

Nr. 1745 Prot

Rrëshen, me 28/04/2021

NJOFTIMI I ANKANDIT

1.Autoriteti shitës: Bashkia Mirditë, Adresa “sheshi Abat Doçi”

2.Data e zhvillimit të ankandit 26.05.2021 ora 13.00

3.Lloji i Procedurës standarde te ankandit
Ankandi do të zhvillohet me **procedurë të hapur**.

Objekti i Shitjes: “Dhënie me qira e pasurisë së paluajtshme sipas udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 ”Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për Dhenie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosur Publik”: që i përket ekonomisë pyjore: **“Ulëz”** njësia Administrative Kthellë, **me sipërfaqe prej 0, 1631 ha me afat perdorimi (qiraje), 10 (dhjetë) vite në numrat e pasurisë nr. 93 a zk.2916, vol.4, faqe 128 me çertifikatë pronësie nr. 2001032 serie date 24.10.2019; me objekt: Për qëllime pushimi, argëtimi”**

4.Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes; Dhënie me qira e pasurisë së paluajtshme sipas udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 me objekt: Për qëllime pushimi, argëtimi”

Ekonomia pyjore	Ngastra	Përdorimi i territorit	Sip. ha	Sipërfaqja me Qira ha	Tarifa dhënie në përdorim lek/ha/vit	TOTALI lekë
					6 deri 10 vjet	
1	2	3	4	5	6	7
Ndërfanë.lugina e lumit Fan i madh	93 a		0,1631 ha	0,1361 ha	12 232.5 leke/vit	
TOTAL						

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

5.Vlera fillestare total **shuma totale është 12 232.5 (dymbëdhjetemije e dyqind e tridhjetë e dymijë presje pese) lekë** sipas raportit tekniko-ekonomik,nga sektori pyjor.

6.Vendi i zhvillimit te ankandit: (Adresa:)

Bashkia Mirditë, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike
Sheshi "Abat Doçi" Rrëshen.

7.Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

26.05.2021 ora 13.00

, ofertat duhet të jenë të hartuara në gjuhën shqipe.

8.Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po				
	Monedha	Lek	Çmimi	3000

9. Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

Kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet e kërkuara

Në përputhje me LAP, Kandidatet blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:

- a. formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b. kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre adresën e subjektit, telefon, *email* dhe faks;
- c. ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë;
- d. çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- e. ne rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit te ankandit
- f. të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron
- g. lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
- h. garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- i. të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë, ne lidhje me objektin e ankandit;
- j. vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime ndaj Bashkisë Mirditë.

Kriteret qe do te vlerësohen dhe sistemi i pikezimit;

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshtë:

- a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;
- b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
- c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
- e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.